

**RENDI I DITËS**

**Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesës ankimore nr. 21, 22 dhe 23”.**

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, z. E. Mema.**

**Znj. M. Çelmeta:** Përshendetje! Sot më datë 14 nëntor 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për 3 kërkesa ankimore. Kërkesa ankimore nr. 21, me ankues Partia Demokracia Sociale, kërkesa ankimore nr. 22, me ankues Partia Aleanca Maqedonase për Integrimin European dhe kërkesa ankimore nr. 23, me ankues Partia Socialiste e Shqipërisë. Këto kërkesa kanë si objekt kundërshtimin e vendimit nr. 186, datë 8.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14, të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në tre prej tyre janë shënuar kërkesat ankimore dhe dy shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ të tërheqë goglat në emër dhe për llogari të tyre për caktimin e relatorit. Viojmë me futjen e shiritave të letrës në gogla. Viojmë me përzierjen e tyre.

Hapim goglën e parë shiriti është i bardhë dhe pa shënim.

Hapim goglën e dytë shiriti është përsëri i bardhë dhe pa shënim.

Hapim goglën e tretë dhe shiriti është me shënim “kërkesa ankimore nr. 22”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 14.11.2024*

Hapim goglën tjetër dhe shiriti është me shënim “kërkesa ankimore nr. 23”.

Hapim goglën e fundit dhe kjo është me shënimin “kërkesa ankimore nr. 21”.

Në përfundim të procedurës së shortit:

---

Relator për kërkesën ankimore nr. 21 është zoti Ledio Braho.

Relator për kërkesën ankimore nr. 22 është zoti Ilirjan Rusmali.

Relator për kërkesën ankimore nr. 23 është Koli Belë.

Faleminderit!

---

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

